

VENDIM
Nr.1263, datë 23.12.2009

**PËR MIRATIMIN DHE PUBLIKIMIN ZYRTAR TË NOMENKLATURËS SË KOMBINUAR
TË MALLRAVE, 2010**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të neneve 1 e 12 të ligjit nr.9416, datë 21.12.2005 “Për nomenklaturën e mallrave dhe tarifën doganore”, të ndryshuar, me propozimin e Ministrisë të Financave, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Miratimin dhe publikimin zyrtar të Nomenklaturës së Kombinuar të Mallrave, 2010, sipas lidhjes nr.1 që i bashkëlidhet këtij vendimi dhe është pjesë përbërëse e tij.

2. Vendimi nr.1672, datë 24.12.2008 i Këshillit të Ministrave “Për miratimin dhe publikimin zyrtar të Nomenklaturës së Kombinuar të Mallrave, 2009”, si dhe çdo dispozitë tjetër, që bie në kundërshtim me këtë vendim, shfuqizohen.

3. Ngarkohen Ministria e Financave dhe Drejtoria e Përgjithshme e Doganave për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi më 1 janar 2010, me përjashtim të kapitullit 99 të lidhjes nr.1, i cili hyn në fuqi me miratimin e nivelit të tarifës doganore përkatëse, në përputhje me legjislacionin në fuqi, dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha